

**Raporti vjetor
Godišnji izveštaj
Annual Report
2009**

**Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
Ustavni sud Republike Kosovo
The Constitutional Court of the Republic of Kosovo**

Përmbajtja / Sadržaj / Table of Contents

Raporti vjetor 2009	1
Godišnji izveštaj 2009	35
Annual Report 2009	69

Raporti vjetor 2009

Raporti i parë vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vitin 2009

Përmbajtja

Deklarata e Misionit	5
Fjala hyrëse nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Prof. Dr. Enver Hasani.....	7
Fjala hyrëse nga Sekretarja e Përgjithshme Mr. sc. Arbëresha Raça-Shala	9
Raporti i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2009.....	11
Miratimi i Kushtetutës së Kosovës dhe themelimi i Gjykatës Kushtetuese	11
I. Departamenti për Administratë dhe Burime njerëzore	15
II. Departamenti për Regjistrimin e lëndëve, Statistikë dhe Arkiv - DRLSA.....	17
III. Departamenti për Përkrahje profesionale.....	21
IV. Departamenti për Buxhet dhe Financa.....	23
V. Njësia e prokurimit.....	25
Bashkëpunimi ndërkombëtar	29
Donatorët dhe asistenca për Gjykatën.....	30
Shtojca I.....	33
Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2009.....	33

Deklarata e Misionit

Gjykata Kushtetuese e Kosovës është:

- Institucion profesional, kompetent dhe i pavarur, për krijimin e një tradite të re, të paanësisë dhe llogaridhënies gjyqësore – që është plotësisht në shërbim të qytetarëve të Kosovës;
- Institucion transparent, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve dhe komuniteteve në Kosovë, duke gjykuar në mënyrë të drejtë dhe transparente brenda kompetencave që ka, duke balancuar barazinë dhe duke mbikëqyrur drejtësinë në ushtrimin dhe përdorimin e pushtetit që është dhënë nga Kushtetuta; dhe
- Autoriteti i fundit i kornizës kushtetuese në vend që siguron dhe mbështet tranzicionin në Kosovë drejt prosperitetit, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Fjala hyrëse nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Prof. Dr. Enver Hasani

Gjykata Kushtetuese është shumë e kënaqur që publikon Raportin e saj të parë Vjetor për publikun. Republika e Kosovës ka miratuar një kushtetutë të fuqishme që garanton standardet më të larta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Kosovë për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Që nga krijimi i saj dhe fillimi i punës së saj Gjykata ka qenë e angazhuar në sigurimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave.

Zanafilla dhe fillimi i punës së Gjykatës kanë paraqitur vështirësi unike të cilat nuk do të kishin qenë të mundura të adresohen pa angazhimin dhe përkushtimin e gjyqtarëve dhe stafit të gjykatës dhe Sekretariatit të Përkohshëm. Gjykata njeh dhe vlerëson punën e shkëlqyer që është bërë nga Sekretariati i Përkohshëm dhe që bëhet nga Sekretariati i Përhershëm, i cili është bërë funksional në shtator të vitit 2009. Që nga zanafilla e saj, sfidat e veçanta me të cilat është ballafaquar stafi i Gjykatës në ditët e para të krijimit të Gjykatës ishin të vështira por u tejkaluan me kujdes, energji dhe entuziazëm. Unë përgëzoj të gjithë stafin e Gjykatës Kushtetuese për mënyrën profesionale dhe të përkushtuar në të cilën u tejkaluan këto vështirësi, në një kohë aq të shkurtër duke e bërë të mundur që Gjykata të funksionojë plotësisht nga shtatori 2009.

Megjithë subvencionimin nga buxheti shtetëror i Kosovës, Gjykata nuk do të kishte qenë në gjendje për të arritur atë që ka bërë pa ndihmën dhe asistencën e dhënë nga donatorët të cilët kanë kontribuar shumë bujarisht me aftësi, ekspertizë dhe burime në fillim të punës së Gjykatës dhe të cilët ende ofrojnë asistencë të vazhdueshme. Në veçanti, Gjykata shpreh falënderimin e saj për Institutin, "East West Management Institute", Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (TIKA), Departamentin për Zhvillim Ndërkombëtar nga Mbretëria e Bashkuar (DFID), Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) dhe Zyrën Civile Ndërkombëtare. Detajet e ndihmës që këto organe kanë ofruar për Gjykatën janë të përcaktuara në një pjesë të Raportit Vjetor.

Më 1 shtator 2009, Gjykata e përshëndeti emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese në pajtim me dispozitat e Nenit 152 të Kushtetutës. Emërimi i tyre, nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, Peter Feith, i mundësoi Gjykatës që të fillojë menjëherë punën pas betimit të tyre. Gjykata gjithashtu i mirëpriti këshilltarët ligjorë ndërkombëtarë të financuar nga Zyra Civile Ndërkombëtare.

Këto etapa të hershme të formimit të Gjykatës do të çojnë përfundimisht në zhvillimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe do t'i mundësojë asaj për të kryer funksionin e saj kryesor, si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës.

Prof. Dr. Enver Hasani
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Fjala hyrëse nga Sekretarja e Përgjithshme Mr. sc. Arbëresha Raça-Shala

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese është një mekanizëm që mbështet dhe siguron funksionimin efikas të Gjykatës, duke mbështetur gjyqtarët dhe palët që paraqiten para Gjykatës. Parimet themelore që ndikojnë në punën e Sekretariatit janë efikasiteti, integriteti profesional, transparencja dhe llogaridhënia.

Kjo periudhë raportuese ishte sfiduese në vetvete, jo vetëm për shkak se gjatë kësaj kohe u vunë themelet e një institucioni të ri, por edhe për shkak të vështirësive të ndryshme, të procedurave që hapën rrugën për themelimin dhe konsolidimin e procesit të Gjykatës. Përkundër faktit që puna e Sekretariatit ishte mjaft shpesh “e padukshme” brenda dhe jashtë Gjykatës, gjatë kësaj kohe të raportimit, personeli i Gjykatës ishte i shkëlqyeshëm në punën e tij dhe u dallua me profesionalizëm të lartë, ndonëse me burime të kufizuara njerëzore, nën presionin e kohës dhe pritjet e publikut, ai siguroi zbatimin e suksesshëm të punës në Gjykatë.

Gjatë periudhës raportuese, Sekretariati u përqendrua në këto fusha strategjike:

- Udhëheqje dhe udhëzim administrativ;
- Procedim të rasteve;
- Përkrahje profesionale;
- Menaxhim të Buxhetit.

Përkundër të gjitha pengesave të tjera të ndryshme që hasi gjatë kësaj periudhe kohore, Sekretariati arriti realizimin e të gjitha qëllimeve dhe objektivave të paracaktuara në masë mjaft të konsiderueshme.

Përfitoj nga rasti të falënderoj singlerisht të gjithë personelin e Sekretariatit për arritjen e këtyre rezultateve përmes mbështetjes së tyre të përkushtuar në punën e Gjykatës. Gjithashtu, do të doja të falënderoja Institutin “East West Management Institute” dhe Qeverinë Britanike për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm dhe të pashoq drejt konsolidimit të punës së Gjykatës.

Ky raport përmban një përmbledhje gjithëpërfshirëse, dhe detaje të punës komplekse që është bërë nga Gjykata në vitin 2009, si dhe programin e zhvillimit të vazhdueshëm drejt bërjes së Gjykatës si një nga organet më të rëndësishme kushtetuese në Kosovë.

Së fundi, në emër të Sekretariatit, unë do të doja të falënderoj Kryetarin e Gjykatës dhe të gjithë gjyqtarët për mbështetjen e tyre të vazhdueshme profesionale, për bashkëpunimin e tyre dhe mirëkuptimin e rrethanave, në të cilat Sekretariati ka punuar, dhe mbi të gjitha dhe më e rëndësishmja, kontributin e tyre në arritjen e rezultateve të paraqitura më poshtë në këtë raport.

Mr. sc. Arbëresha Raça-Shala

Sekretare e Përgjithshme

Raporti i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2009

Miratimi i Kushtetutës së Kosovës dhe themelimi i Gjykatës Kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), e miratuar nga Kuvendi i Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Neni 112 i Kushtetutës parasheh themelimin e Gjykatës Kushtetuese e cila është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese (Ligji nr 03/L-121) u miratua më 16 dhjetor 2008 dhe hyri në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 15 janar 2009. Neni 57 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ka krijuar një Sekretariat të përkohshëm, deri në atë kohë kur Sekretariati u bë plotësisht funksional. Kjo ndodhi në shtator të vitit 2009 me punësimin e përhershëm të Sekretares së Përgjithshme dhe stafin e saj mbështetës të Drejtorive të cilat janë të theksuara në këtë raport.

Struktura dhe organizimi i Gjykatës

Përbërja e Gjykatës është e përcaktuar nga Kushtetuta e Kosovës. Gjykata përbëhet nga nëntë gjyqtarë të cilët kërkohen që të jenë juristë të dalluar dhe personalitete me moral të lartë. Gjashtë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit të Kosovës. Tre gjyqtarët ndërkombëtarë, Snezhana Botusharova, Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues, janë emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përbërja e plotë e Gjykatës është:

Enver Hasani, kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare



Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës



Kryetari Enver Hasani



Zëvendëskryetari Kadri Kryeziu



Gjyqtari Robert Carolan



Gjyqtari Altay Suroy



Gjyqtari Almiro Rodrigues



Gjyqtarja Snezhana Botusharova



Gjyqtari Ivan Čukalović



Gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj



Gjyqtarja Iliriana Islami

Gjykata mbanë seancat në Prishtinë, por mund t'i mbajë ato edhe jashtë Prishtinës, nëse vendos kështu. Zyrat e përhershme të Gjykatës janë në Perandori Justinian, Qyteza Pejton, Prishtinë.



Hyrja në Gjykatën Kushtetuese

Kompetencat dhe funksionet e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit janë të përcaktuara me ligj. Në bazë të kompetencave të saj, Gjykata miraton Rregulloren e Punës që qeveris punën e parashtrimit të kërkesave në Gjykatë dhe punën e brendshme të Gjykatës. Rregullorja e Punës u miratua nga Gjykata në seancën e saj të parë administrative, më 26 qershor 2009, dhe ajo mund të ndryshohet dhe të plotësohet nga Gjykata kohë pas kohe në varësi të nevojës. Rregullorja e Punës është e gatshme në faqen e internetit të Gjykatës: <http://www.gjk-ks.org>.

Administrata e Gjykatës Kushtetuese dhe puna e Departamenteve të Gjykatës

Sipas Nenit 57 të Ligjit nr. 03/L-12, u themelua Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës. Ai funksionoi deri më 31 gusht, kur Sekretariati i Gjykatës u bë plotësisht funksional, veçanërisht pas emërimit të Sekretares së Përgjithshme, Znj. Arbëresha Raça-Shala.

Për shkak se Gjykata Kushtetuese kishte filluar punën e saj si organ shtetëror krejtësisht i ri, Sekretariati hasi vështirësi të konsiderueshme që vinin si rrjedhojë e mungesës së kushteve elementare të punës dhe mungesës së personelit të administratës. Megjithatë, Sekretariati i Përkohshëm dhe Sekretariati i Përhershëm i kapërcyen këto vështirësi dhe mbështetën punën e Gjykatës, dhe kjo ju lejoi gjyqtarëve shqyrtimin e të gjitha kërkesave të parashtruara në Gjykatë gjatë periudhës raportuese.

Sekretariati i Përkohshëm informoi publikun nëpërmjet njoftimeve publike lidhur me fillimin e punës së Gjykatës dhe krijoi një sistem të regjistrimit të rasteve, inicioi disa rregulla administrative, ndihmoi në përgatitjen e projekt-rregullores së punës, hartoi formularin për pranimin e kërkesave në gjykatë, dhe shumë hapa të tjerë të domosdoshëm për t'i mundësuar Gjykatës fillimin e funksionimit në emër të qytetarëve të Kosovës. Kjo përfshinte punën me organet e tjera shtetërore gjatë periudhës së përkohshme dhe mbulimin e kërkesave për këshillim dhe rekrutimin në Gjykatë. Kjo punë efikase dhe e përkushtuar fillestare, rezultoi në dorëzimin e njëtrajtshëm dhe efikas të punës tek Sekretariati më 1 shtator 2009.

Plani mujor i punës u prezantua për periudhën shtator-dhjetor 2009, i dedikuar për realizimin e tri objektivave kryesore:

- Rekrutimin e stafit drejtues (menaxhues) dhe personelit tjetër administrativ;
- Sigurimin e kushteve themelore të punës; dhe
- Themelimin e departamenteve të reja dhe konsolidimin e funksioneve të Departamentit për Regjistrim të lëndëve, i cili gjatë periudhës së Sekretariatit të përkohshëm funksiononte si Zyrë regjistrimi e Sekretariatit të përkohshëm.

Në fillim të shtatorit 2009, Sekretariati përgatiti përshkrimet e punës për pozitat e punës dhe shpalli konkursin e parë për 26 vendet e lira për 21 pozita të ndryshme.

Rreth 1.100 persona aplikuan për vendet e lira në Gjykatën Kushtetuese në procesin e rekrutimit. Planet e punës për muajin shtator 2009 u kryen dhe ato ishin për menaxhimin e plotë të proceseve të parashtrimit të kërkesave, hartimin e listave për aplikimet për punë dhe u kryen aktivitete të tjera të ndërlidhura me shërbimet administrative. Gjithashtu, gjatë shtatorit u përzgjodhën pesë kryesues të departamenteve dhe pesë persona të tjerë të stafit administrativ, për të filluar punën në tetor të vitit 2009.

Në tetor 2009, drejtorëve të departamenteve u janë deleguar përgjegjësitë siç parashihej në përshkrimin e tyre të punës, por në mungesë të një kuote të plotë të personelit administrativ, shumë punë u kryen në bashkëpunim, ku anëtarët e stafit kryen punë të shumta në të njëjtën kohë.

I. Departamenti për Administratë dhe Burime njerëzore

Punët e përgjithshme administrative

Aktivitetet e ndërmarra përfshijnë:

- Analizat e sistemit të TI-së të instaluar në Gjykatë (harduer, softuer, rrjetet kompjuterike dhe telefonike), dhe konsolidimi i tyre;
- Hartimin e koncept-dokumentit për dixhitalizimin e proceseve të punës në të gjitha fazat, nga pranimi i rasteve në Gjykatë, dhe deri te arkivimi dhe përdorimi i rasteve online;
- Organizimin dhe mbikëqyrjen e instalimit të kamerave të sigurisë dhe pajisjeve të regjistrimit video/audio në sallën e gjykimeve dhe në Zyrën për medie;
- Zgjerimin dhe konsolidimin e rrjeteve telefonike, përfshirë edhe riprogramimin e centralit telefonik;
- Sigurimin e pajisjeve të TI-së dhe inventarit tjetër të punës, përmes huazimit nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim të përmbushjes së kërkesave themelore të punës për stafin administrativ të Gjykatës;
- Konsolidimin e depoz për magazinimin e inventarit dhe materialit shpenzues, si dhe furnizimin e zyrave me material tjetër;
- Organizimin dhe mbikëqyrjen e mobilimit me inventar pune dhe furnizime të tjera për të gjitha hapësirat e punës së Gjykatës;
- Aktivitete të tjera të shumanshme, përfshirë edhe përgatitjet lidhur me vizitën e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë dhe punësimin e një kompanie të veçantë për mirëmbajtjen e Gjykatës.

Burimet njerëzore

Më poshtë mund të shihni një pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve të ndërmarra nga ana e Zyrës së Burimeve njerëzore.

Përgatitja dhe zbatimi i procedurave të rekrutimit për postet të tjera të shpallura në 2009 rezultuan në:

- Përzgjedhjen e 7 anëtarëve të stafit profesional dhe niveleve mbështes, përmes zbatimit të politikave jodiskriminuese sa i përket përfaqësimit gjinor dhe përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve të tjera, në pajtim me udhëzimet administrative dhe procedurat e personelit;
- Përzgjedhjen e zëdhënësit dhe zyrtarit ligjor përmes rishpalljes së vendit të punës;
- Administrimin e procesit të rekrutimit dhe mbikëqyrja e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për vendet e punës këshilltar ligjor;
- Përgatitjen e përskrimit të detyrave të punës për 19 vende të planifikuara pune, shpallja e konkurseve dhe përzgjedhja e personelit ndihmës administrativ;
- Përpilimin dhe plotësimin e pyetësorëve lidhur me nevojat për trajnim të stafit administrativ;
- Analizën dhe vlerësimin e kërkesave, për të identifikuar fushat e trajnimit për ndërtimin e kapaciteteve të zyrtarëve të Gjykatës për vitin 2010;
- Hartimin e Rregullores së punës për klasifikimin dhe gradimin e pozitave të punës, përcaktimin e normave dhe shpërblimeve, duke synuar një politikë efikase për menaxhimin e burimeve njerëzore; dhe në
- Hartimin e udhëzimeve për çështje administrative për një funksion efikas të Sekretariatit:
 - ✓ Udhëzimi Administrativ për shfrytëzimin e veturave zyrtare;
 - ✓ Udhëzimi Administrativ për shpenzimet e telefonit;
 - ✓ Udhëzimi Administrativ për reprezentacion;
 - ✓ Udhëzim Administrativ për shujtën;
 - ✓ Udhëzim Administrativ për shfrytëzimin e parkingut; dhe
 - ✓ Udhëzim Administrativ për depon.

II. Departamenti për Regjistrimin e lëndëve, Statistikë dhe Arkiv - DRLSA

Gjatë aktiviteteve të Sekretariatit të përkohshëm, ky departament funksiononte edhe si Zyrë regjistrimi për Sekretariatit e përkohshëm. Nga 1 shtatori 2009, ai u emërtua Departamenti për Regjistrimin e lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA).

1. Numri i kërkesave


Kërkesa e parë ishte regjistruar më 2 shkurt 2009. 35 kërkesa u regjistruan deri më 31 gusht 2009 dhe 44 kërkesa gjatë periudhës 1 shtator - 31 dhjetor 2009.

Gjithsej 79 kërkesa janë regjistruar gjatë vitit 2009.

Ndarja e kërkesave të pranura gjatë periudhës së funksionimit të Sekretariatit të përkohshëm dhe Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kohës së arritjes, është:

- ✓ 35 kërkesa të regjistruara në periudhën 2 shkurt – 31 gusht 2009, nga të cilat:
 - 1 kërkesë e parashtruar nga nënkryetari i Komunës së Prizrenit; dhe
 - 34 kërkesa të paraqitura nga individë të cilët pretendojnë shkelje të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- ✓ 44 kërkesa të regjistruara në periudhën 1 shtator – 31 dhjetor 2009, të gjitha të parashtruara nga individë.

Tabela mujore e kërkesave të parashtruara gjatë vitit 2009.




2. Shkelësit e supozuar të të drejtave

Kërkesat që kishin të bënin me shkeljet e supozuara nga ana e gjykatave, prokurorive dhe policisë përbëjnë më tepër se gjysmën e kërkesave të parashtruara në vitin 2009 ose 60.76 %. 39.24% të kërkesave ishin kundër palëve të tjera. Më poshtë kemi paraqitur një ndarje më të specifikuar.

Shkeljet e supozuara të të drejtave:

- në 48 ose 60.76% të kërkesave, parashtruesit pretendojnë se gjykatat, prokuroritë dhe Shërbimi policor i Kosovës ua kanë shkelur të drejtat e tyre;
- në 13 ose 16.46 % të kërkesave, parashtruesit pretendojnë se institucionet e tjera shtetërore ua kanë shkelur të drejtat e tyre;
- në 11 ose 13.92% të kërkesave, parashtruesit pretendojnë se autoritetet e tjera publike ua kanë shkelur të drejtat e tyre;
- në 5 ose 6.33% të kërkesave, parashtruesit pretendojnë se UNMIK-u dhe EULEX-i ua kanë shkelur të drejtat e tyre; dhe
- në 2 ose 2.53% të kërkesave, parashtruesit pretendojnë se personat privatë ua kanë shkelur të drejtat e tyre.

Paraqitja grafike e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut, të ndara në përqindje:



3. Objekti i kërkesave

Kërkesat që kërkonin vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore lidhur me shkeljet e supozuara të të drejtave të tyre për:

- ✓ Gjykim të drejtë, në 18.99 % të rasteve;
- ✓ Të drejtën në pension, në 21.52 % të rasteve;
- ✓ Të drejtën për punë, në 6.33 % të rasteve; dhe
- ✓ Të tjera, në 53.15% të rasteve.

4. Pranimi i kërkesave dhe ndarja e punës

Sekretariati i Gjykatës i ka regjistruar të gjitha kërkesat sipas Nenit 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese. Shpërndarja e kërkesave është bërë sipas Nenit 7 të Rregullores së punës, dhe sipas datës së dorëzimit në Gjykatë. Kërkesave për vënien e masave të përkohshme u është dhënë prioritet dhe janë ndarë menjëherë.

Në vitin 2009 Gjykata ka marrë këto vendime:

- 4 kërkesa janë refuzuar si të papranueshme;
- 3 kërkesa për masa të përkohshme janë refuzuar si të papranueshme; dhe
- 2 kërkesa për masa të përkohshme janë miratuar.

Sekretariati ka siguruar shërbime mbështetëse për gjyqtarët në seancat e kolegjeve shqyrtuese dhe në seancat dëgjimore të Gjykatës për:

- 12 kolegje shqyrtuese;
- 4 seanca plenare; dhe
- 2 seanca dëgjimore.

Vendimet e Gjykatës janë të publikuara në faqen e internetit të Gjykatës Kushtetuese, <http://www.gjk-ks.org/> dhe në Gazetën Zyrtare, si dhe u janë dërguar secilës palë të kërkesës.

III. Departamenti për Përkrahje profesionale

Departamenti për Përkrahje profesionale (DPP) ka filluar punën në kuadër të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese në fillim të tetorit të vitit 2009 me emërimin e drejtorit të Departamentit.

DPP është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, redaktimit, lekturës dhe hulumtimit ligjor. Me gjithë pengesat, jo pak të ndërlidhura me vështirësitë në fazat e hershme të rekrutimit të personelit, DPP aranzhoi përkthimin dhe procedimin e rreth 2000 faqeve, ose 33 faqe në ditë, të letrave dhe dokumenteve të ndryshme në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe turke. DPP gjithashtu organizoi përkthimin për takimet e rregullta dhe seancat e Gjykatës.

Në koordinim me DRLSA, DPP përgatiti dokumentacionin e nevojshëm për seancat e Gjykatës.

Për të lehtësuar vëllimin e punës është angazhuar një kompani profesionale e përkthimit, e me Njësinë e Prokurimit janë blerë pakot softuerike profesionale:

- Softuerin për përkthim automatik;
- Softuerin për memorizim të terminologjisë së fushës profesionale;
- Softuerin për njohje optike të karaktereve; dhe
- Korrektoret automatikë të drejtshkrimit për gjuhën serbe dhe turke.

Gjykata procedon një sasi të madhe të informacionit që duhet të administrohet edhe nga Sekretariati, me qëllim që t'u shërbejë gjyqtarëve dhe qytetarëve, në kohë dhe me cilësi.

Për të mundësuar që kjo të realizohet, DPP ka filluar skanimin e dosjeve dhe dokumenteve për të pasur akses më të lehtë dhe të shpejtë në to. Departamenti ndihmoi në hartimin e një fjalori tregjuhësh për t'u përdorur në Gjykatë. DPP është gjithashtu i ngarkuar për krijimin e një Sistemi elektronik të menaxhimit të lëndëve për t'ua mundësuar gjyqtarëve dhe stafit të Gjykatës marrjen e shpejtë të informacionit lidhur me lëndët, dhe për t'u ofruar shërbime cilësore parashtruesve dhe qytetarëve.

IV. Departamenti për Buxhet dhe Financa

Departamenti për Buxhet dhe Financa i Gjykatës Kushtetuese ndihmon në sigurimin e informatave rreth financimit dhe kontabilitetit që janë të nevojshme për Gjykatën për të kryer obligimet e saj, që ndër të tjera përfshijnë përgatitjen e llogarisë për të ardhurat dhe shpenzimet, informatat për shpenzimet kapitale dhe këshillimin për përgatitjen e buxhetit vjetor. Në tetor të vitit 2009, Departamenti për Buxhet dhe Financa mori përsipër të gjitha çështjet e lidhura me buxhet dhe financa, të cilat ishin menaxhuar më parë nga Ministria e Administratës Publike. Një përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2009 është paraqitur në Shtojcën I të këtij Raporti. Llogaritë e plota u janë dorëzuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave/Departamentit të Thesarit. Këto llogari i nënshtrohen auditimit nga Auditori i përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

V. Njësia e prokurimit

Gjatë vitit 2009, Njësia e prokurimit e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka iniciuar gjithsej 38 kërkesa për furnizim me mallra dhe kryerje të shërbimeve. Më poshtë është një përmbledhje e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të ndryshme të prokurimit.

I. Aktivitetet e prokurimit të iniciuara nga Ministria e Administrimit Publik (MAP)

Para se Gjykata të merrte përsipër prokurimin, MAP ka iniciuar 11 (njëmbëdhjetë) aktivitete të prokurimit për furnizimin fillestar me material të zyrës dhe mobile për Sekretariatit e përkohshëm, si: pajisje për TI, laptopë, printerë, dhe tavolina. Vlera totale e kontratave të lidhura nga MAP nga buxheti i vitit 2009 për Gjykatën Kushtetuese arriti në 116,595.20 €.

II. Procedurat e hapura

3 (tri) kontrata janë nënshkruar në procedurë të hapur: për shërbime të përkthimit, për furnizim me materiale shpenzuese të zyrës, pajisje të TI-së, softuerë dhe pajisje të tjera shtesë.

III. Procedurat për kuotimin e çmimeve

9 (nëntë) kontrata janë nënshkruar përmes procedurave për kuotimin e çmimeve: për pajisje shtesë të TI-së dhe sigurimin e automjeteve zyrtare.

IV. Procedura me vlerë minimale

11 (njëmbëdhjetë) kontrata janë nënshkruar përmes procedurës me vlerë minimale: për furnizim me ormana metalikë, për furnizim me pajisje për zyrë dhe materiale të tjera (si: vula, kartela, tonera, etj.).

V. Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë

2 (dy) kontrata janë nënshkruar nëpërmjet procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë: për shërbimet postare, dhe për shërbime të publikimit në mjetet e informimit publik.

Vlera totale e kontratave të nënshkruara nga Gjykata Kushtetuese, pas vendosjes së aranzhimeve fillestare të prokurimit nga MAP, arriti në 74,176.87 €.

PËRSHKRIMI	SHUMA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA	SHUMA E PAGUAR
Blerje përmes tenderit	121,333.62 €	105,408.22 €
Blerje përmes kuotimit të çmimit	58,846.53 €	58,358.53 €
Blerje përmes procedurës me vlerë minimale të çmimit	10,359.34. €	10,359.34. €
Blerje me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë		40.30 €
Gjithsej	190,539.49 €	174,166.39€
Pagesat sipas kontratës afatgjate		22,062.16 €
GJITHSEJ	190,539.49 €	196,228.55€

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Krijimi i lidhjeve me Gjykatat e tjera Kushtetuese në rajon dhe më gjerë është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të Gjykatës, jo vetëm për të ndihmuar atë në gjenerimin e një praktike gjyqësore që do të jetë pjesë jetike e kuadrit ligjor të Kosovës, por edhe për ta ndihmuar Republikën e Kosovës për ta zënë vendin e saj në mesin e bashkësisë së kombeve. Për të ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave, në vitin 2009, gjyqtarët e Gjykatës kanë ndërmarrë vizita zyrtare, ndër të tjera, në:

- Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Turqisë;
- Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- Konferencën Rajonale - E drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme - Shkup, Maqedoni;
- Kongresin Ndërkombëtar "Evropa dhe Kushtetutat e saj: 20 vjet më vonë" - Regensburg/Gjermani;
- Institutin për Kërkime folklorike në Ankara / Turqi; dhe
- Bashkëpunimin në nivel rajonal me qëllim të avancimit të përbashkët në fushën e sundimit të ligjit, Shkup, Maqedoni.

Gjykata do të vazhdojë t'i zhvillojë marrëdhëniet e saj ndërkombëtare me gjykatat e tjera kushtetuese, dhe institucionet edhe në vitin 2010 dhe në vitet në vijim.

Donatorët dhe asistenca për Gjykatën

Gjykata, si gjykatë e re kushtetuese në Republikën e Kosovës ka pasur asistencë mjaft bujare dhe ndihmë nga shumë donatorë në detyrën e vështirë të fillimit të punës së saj dhe të themelimit si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata me mirënjohje ka pranuar ndihmën dhe asistencën e ofruar nga:

East West Management Institute

Instituti "East-West Management Institute" Inc. (EWMI) është themeluar në vitin 1988 si organizatë e pavarur, jo fitimprurëse, e cila ndihmon në promovimin e sundimit të ligjit, shoqërisë civile dhe sistemeve të tregut të lirë në shumë vende të botës. EWMI fillimisht ka ofruar ndihmë për të mundësuar funksionimin e Sekretariatit të përkohshëm. Instituti ka ndihmuar duke krijuar një sistem të menaxhimit të lëndëve, në rekrutim, hartimin e Rregullores së punës dhe në ofrimin e ekspertizës teknike për përkthim, si dhe në çështje të tjera. EWMI ka qenë gjithashtu i rëndësishëm në zhvillimin e planit strategjik për Gjykatën Kushtetuese. Gjykata është shumë mirënjohëse për këtë asistencë.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë e ka ndihmuar Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në ndërtimin dhe pajisjen e gjykatores në ndërtesën e saj në Prishtinë. Kjo ndihmë u zbatua nga Agjencia e Qeverisë Turke për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (TIKA). TIKA siguron bashkëpunimin ekonomik, komercial, teknik, social, kulturor dhe arsimor në vendet në zhvillim nëpërmjet projekteve që synojnë të ndihmojnë zhvillimin e këtyre vendeve.

Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID)

DFID ka dhënë ndihmë për Gjykatën Kushtetuese, fillimisht në ofrimin e ndihmës për Sekretariatin e përkohshëm në fillim të punës së tij, sipas Nenit 57 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Në bashkëpunim me Institutin "East West Management Institute" (EWMI), është dhënë asistencë për zhvillimin e planeve të punës së Gjykatës, dhe në strategjinë e ardhshme, përmes organizimit të seminareve të punës, të mbajtura në tetor 2009, dhe përmes asistencës së vazhdueshme dhe rishikimit të Gjykatës, organizimit të saj të brendshëm dhe zhvillimit.

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

USAID-i ka punuar ngushtë me Gjykatën në dhënien e asistencës së vlefshme, përmes sigurimit të ekspertëve të njohur, të cilët kanë asistuar në shqyrtimin e Rregullores së punës së Gjykatës. Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009, USAID-i ka projektuar një program të shpejtë në mbështetje të Gjykatës, që ka qenë i fokusuar kryesisht në ofrimin e ndihmës teknike dhe ekspertizës në fusha specifike, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në shkrimin e opinioneve gjyqësore dhe interpretimin kushtetues. Për këtë qëllim, USAID-i ka angazhuar gjyqtarin e Gjykatës Federale të Qarkut Z. John R. Tunheim në mbështetje të Gjykatës Kushtetuese. Asistenca e USAID-it përbëhej kryesisht prej konsultimeve profesionale dhe mundësimit të diskutimeve ndërmjet Gjykatës dhe një ekipi gjyqësor amerikan, të kryesuar nga gjyqtari Tunheim.

Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik GmbH (GTZ) Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit GmbH

GTZ ka dhënë asistencë të konsiderueshme në Gjykatën Kushtetuese, siç është pajisja me libra e bibliotekës dhe ofrimi i asistencës teknike sidomos në blerjen e një numri të konsiderueshëm të teksteve juridike, pa të cilat secila gjykatë do të përballej me vështirësi të konsiderueshme. Seminari i parë u organizua në shtator të vitit 2009 në ambientet e GTZ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë. Qëllimi i seminarit ishte paraqitja dhe shkëmbimi i përvojave profesionale në gjyqësinë kushtetuese, me theks të veçantë në të drejtat themelore të njeriut. Gjykata është shumë mirënjohëse për angazhimin e plotë dhe aktiv të GTZ-së në zhvillimin e saj.

Zyra civile ndërkombëtare (ICO)/Përfaqësuesi civil ndërkombëtar (EUCR)

Përfaqësuesi civil ndërkombëtar ka emëruar tre gjyqtarë ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat kushtetuese. ICO gjithashtu ka ofruar asistencë për Gjykatën në sigurimin e përkthyesve, tre këshilltarëve ligjorë ndërkombëtarë dhe një këshilltareje për gjyqtarët ndërkombëtarë.

Shtojca I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2009

Pasqyra e pranimit dhe e pagesave në para të gatshme				
2009				
Llogaria e vetme në thesar				
		BKK	THV	
		€ <000	€ <000	
		Shënim		
Pranimet				
Ndarjet nga fondi i përgjithshëm	2	313,001.74		
Ndarjet nga fondi me qëllim të dedikuar				
Grantet e caktuara të donatorëve	3			
Pranimet të tjera	4			
Pranime gjithsej		313,001.74	-	
Pagesat				
Operacionet				
Paga dhe medetje	5	100,258.09		
Mallra dhe shërbime	6	121,133.01		
Shpenzime komunale	7	1,076.04		
		222,467.14	-	
Transferet				
Transferet dhe subvencionimet	8			
Shpenzime kapitale				
Prona, dhe pajisjet	9	90,534.60		
Pagesat të tjera	10			
Pagesa gjithsej		90,534.60	-	

Raport mbi ekzekutimin e buxhetit

		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi
	Shënim	A € <000	B € <000	C € <000	D=C-B € <000
Hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e Thesarit					
Taksat	11				
Të hyrat vetanake /	12				
Të hyrat burimore					
Grantet dhe asistenca	13				
Kapitali					
Të hyrat	14				
Privatizimi/Fondi	15				
Të tjera	16				
Pranimet totale të mbledhura nga BKK			-	-	-
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit					
Paga dhe mëditje	17	520,000	520,000	100,258	(419,742)
Mallra dhe shërbime	18	330,000	283,050	121,133	(161,917)
Shërbime komunale	19	67,000	56,950	1,076	(55,874)
Transferet dhe subvencionimet	20				
Shpenzimet kapitale	21	183,000	240,000	90,535	(149,465)
Privatizimi/Fondi	22				
Të tjera	23				
Totali i pagesave i bërë nga BKK		1,100,000	1,100,000	313,002	(786,998)

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2009

	BKK	THV	Totali
Klasifikimi Ekonomik	€ <000	€ <000	€ <000
Paga dhe mëditje	520,000		520,000
Mallra dhe shërbime	283,050		283,050
Shpenzimet komunale	56,950		56,950
Subvencionime dhe Transfere			
Shpenzime kapitale	240,000		240,000
	1,100,000	-	1,100,000